

Nr. Prot. *825*

Datë 17.10.2025

Drejtuar: Inspektoriatit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore
Rr. "Sheh Ahmet Pazar", Nr.10, pranë stadiumit Air Albania, Tiranë

Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive
Bulevardi "Bajram Curri", 1004, Tiranë

Ministritë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit
Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Nr.3, Tiranë

Në vëmendje: z. Albin Gega

Për dijeni: **Ministritë së Infrastrukturës dhe Energjisë**
Rr. "Abdi Toptani", Nr.1, 1001, Tiranë

Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore
Bulevardi "Bajram Curri", Blloku "Vasil Shanto", Tiranë

Këshillit të Ministrave
Bulevardi "Dëshmorët e Kombit" Tiranë

Shoqërisë shtetërore Albpetrol sh.a
Rr. Fier – Patos km. 07, Fier.

Prefektit të Qarkut Fier
Rr. "Ramiz Aranitasi", Lagjia "11 Janari" (9301)

Sindikatës së Sektorit Hidrokarbur
Lagjia "29 Marsi" km.7, Rruga Fier – Patos, Fier

Lënda: Informim

Të nderuar,

Ju informojmë se Sindikata e Sektorit Hidrokarbur po zhvillon një grevë urie prej datës 15.10.2025 në të cilën janë përfshirë punonjësit të shoqërisë Bankers Petroleum Albania Ltd. Megjithatë shoqëria garanton të drejtën kushtetuese të grevës së ligjshme, kërkesat e parashtruara nga Sindikata janë të pambështetura në ligj apo në Kontratën Kolektive.

Sindikata fillimisht parashtroi kërkesën për një rritje me 9% të fondit të pagave duke u alokuar ky fond te punonjësit me paga më të ulëta, kërkesë që me zhvillimin e grevës shohim të jetë

dyfishuar në 18%, si dhe kërkesën për caktimin e një vlere prej 1% të fondit total të pagave të shoqërisë për krijimin e një fondi për Sindikatën.

Asnjë nga kërkesat nuk mbështetet nga ligji apo Kontrata Kolektive nënshkruar mes shoqërisë Bankers dhe Sindikatës së Sektorit Hidrokarbur. Në nenin 23 pika 9 të Kontratës Kolektive shprehimisht kemi përcaktuar se:

"Punëdhënësi, në mbështetje të ligjeve në fuqi si dhe në varësi të mbarëvajtjes së treguesve ekonomikë të Shoqërisë, pas miratimit të Bordit Drejtues të kompanisë dhe institucioneve përkatëse sipas Marrëveshjes Hidrokarbure dhe në marrëveshje me SSH vlerëson masën e fondit të pagave bazë (të punonjësve vendas) të Burimeve Njerëzore çdo vit si dhe shpërndarjen e saj".

Nga interpretimi i dispozitës së mësipërme, rezulton se për të vlerësuar masën e fondit të pagave bazë, duhet që :

- Të ketë një mbarëvajtje të qëndrueshme të treguesve ekonomikë të shoqërisë

Momentalisht treguesit ekonomikë të Shoqërisë vijnë të shënojnë rënie për shkak të sfidave me të cilat po përballen shoqëria aktualisht me të cilat jeni të gjithë të njohur. Po ashtu, pasqyrat financiare të këtij viti ende nuk janë certifikuar.

- Të ketë një miratim të Bordit Drejtues të shoqërisë së bashku me institucionet shtetërore sipas Marrëveshjes Hidrokarbure.

Momentalisht institucionet mbikëqyrëse të veprimtarisë së shoqërisë sikurse edhe vetë shoqëria, janë të angazhuar për zbatimin me rigorozitet të detyrimeve sipas Marrëveshjes Hidrokarbure.

Po ashtu, ju informojmë se Bankers është një nga Punëdhënësit më kompetitivë në Shqipëri sa i përket kushteve të punës ku paga mesatare bruto e punonjësve vendas, që punojnë në fushën Patos Marinëz, në pozicione nën nivelin supervisor është afërsisht 134.000 ALL, duke mospërfshirë këtu kompensimet për orët shtesë, për orët e natës dhe për punën e kryer në ditët e festave zyrtare, të cilat janë pothuajse të përmuajshme, si edhe bonuset. Ndërkohë, që po të konsiderojmë edhe kategoritë e tjera të punonjësve, paga mesatare është ndjeshëm më e lartë. Në takimin e përbashkët që mbajtëm në datën 13.10.2025, shoqëria konfirmoi angazhimin për të rritur vlerën e trajtimit ushqimor, i cili si shtesë e përhershme mujore, do të konsistojë gjithashtu në rritje të pagës mujore të punonjësve.

Kërkesa e Sindikatës për alokimin e këtij buxheti shtesë për kategorinë e pagave të punonjësve me pagë më të ulët siç i konsideron ajo, në gjykimin tonë është një kërkesë diskriminuese, selektive dhe që bie në kundërshtim me qëllimet e vetë Sindikatës. Nga ana tjetër, paga nuk mund të jetë e unifikuar për të gjithë punonjësit pasi përcaktueshmëria e saj varet nga faktorë që janë të lidhur specifikisht me formimin dhe kontributin individual të secilit prej punonjësve në vendin e punës. Ndërsa kërkesa për caktimin e 1% të buxhetit total të pagave të shoqërisë për krijimin e një fondi për Sindikatën është jo vetëm e pambështetur por përbën një luks që shoqëria nuk është në kushtet për ta siguruar.

Ne mendojmë se punonjësit janë aseti ynë më i rëndësishëm dhe i kemi trajtuar të gjithë me respekt, dinjitet dhe vlerësim për punën që bëjnë dhe për kontributin që jep gjithësecili në mbarëvajtjen e kësaj shoqërie. Për këto arsye kërkojmë ndërmjetësimin tuaj për të arritur një zgjidhje me mirëkuptim të përbashkët për të mos shkuar tek përshkallëzimi i mëtejshëm i kësaj situatë!


Me respekt,

Në mungesë dhe me Prokurë

Luntao Chen

Zv. Drejtor i Përgjithshëm

Bankers Petroleum Albania LTD



Hongping Xiao

CEO dhe Drejtor i Përgjithshëm

Bankers Petroleum Albania LTD

Nr. Prot. **B25**

Datë 17.10.2025

To: **State Labour and Social Services Inspectorate**
Rr. "Sheh Ahmet Pazari", Nr.10, pranë stadiumit Air Albania, Tirana

National Employment and Skills Agency
Bulevardi "Bajram Curri", 1004, Tirana

Ministry of Economy, Culture and Innovation
Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Nr.3, Tirana

Attn of: **Mr. Albin Gega**

Attn of: **Ministry of Infrastructure and Energy**
Rr. "Abdi Toptani", Nr.1, 1001, Tirana

National Agency of Natural Resources
Bulevardi "Bajram Curri", Blloku "Vasil Shanto", Tirana

Council of Ministers
Bulevardi "Dëshmorët e Kombit" Tirana

Albpetrol sh.a
Rr. Fier – Patos km. 07, Fier.

Prefect of Fier County
Rr. "Ramiz Aranitasi", Lagjia "11 Janari" (9301), Fier

Hydrocarbon Sector Union
Lagjia "29 Marsi" km.7, Rruga Fier – Patos, Fier

Subject: **Information**

Dear all,

We inform you that the Hydrocarbon Sector Union has been conducting a hunger strike since October 15, 2025, involving employees of Bankers Petroleum Albania Ltd. While the Company guarantees the constitutional right to a lawful strike, the demands put forward by the Union are not supported by law or by the Collective Agreement.

Initially, the Union requested a 9% increase in the wage fund, to be allocated to employees with lower salaries. During the strike, we have observed that this request has effectively

doubled to 18%. Additionally, the Union requested the allocation of 1% of the Company's total wage fund to create a Union fund.

None of these requests are supported by law or by the Collective Agreement signed between Bankers and the Hydrocarbon Sector Union. In Article 23, point 9 of the Collective Agreement, we explicitly stipulate:

"The Employer, based on the applicable laws and depending on the Company's economic performance, after approval by the Company's Board of Directors and the relevant institutions in accordance with the Hydrocarbon Agreement and in coordination with the Union, evaluates the amount of the basic wage fund (for local employees) annually and its distribution."

From the interpretation of the above provision, it follows that in order to assess the amount of the basic wage fund, it is necessary that:

- There is a stable performance of the Company's economic indicators;

Currently, the Company's economic indicators continue to show a decline due to the challenges it is facing, which are known to all of you. Moreover, this year's financial statements have not yet been certified.

- There is approval from the Company's Board of Directors together with the state institutions in accordance with the Hydrocarbon Agreement;

At present, the supervisory institutions overseeing the Company's operations, as well as the Company itself, are engaged in rigorously implementing the obligations under the Hydrocarbon Agreement.

Furthermore, we inform you that Bankers is among the most competitive employers in Albania regarding working conditions. The average gross salary for local employees working in the Patos-Marinëz field, in positions below supervisor level, is approximately 134,000 ALL, excluding overtime compensation, night shifts, work on public holidays (which is almost monthly), and bonuses. When considering other employee categories, the average salary is significantly higher. During the joint meeting held on October 13, 2025, the Company confirmed its commitment to increase the value of the meal allowance, which, as a permanent monthly addition, will also consist of an increase in the employees' monthly salary.

The Union's request to allocate this additional budget for the category of employees with lower wages, as they define it, in our view, is discriminatory, selective, and contrary to the Union's stated objectives. On the other hand, salaries cannot be uniform for all employees, as their determination depends on factors specifically related to the education, skills, and individual contributions of each employee in the workplace. The request to allocate 1% of the Company's total wage budget to create a Union fund is not only unsupported but also represents a luxury the Company is not in a position to provide.

We believe that our employees are our most important asset, and we have treated everyone with respect, dignity, and appreciation for the work they do and the contribution each one makes to the proper functioning of the Company. For these reasons, we seek your mediation to reach a mutually understanding solution to prevent further escalation of this situation.

Respectfully,

In absence and under Power of Attorney

Luntao Chen

Zv. Drejtor i Përgjithshëm

Bankers Petroleum Albania LTD



Hongping Xiao

CEO dhe Drejtor i Përgjithshëm

Bankers Petroleum Albania LTD



SINDIKATA E SEKTORIT HIDROKARBUR

Prot. 51

Patos, më 03.10.2025

Lënda: Njoftim për fillimin e Grevës

BANKERS PETROLEUM ALBANIA
Rr. "Leonardo Murialdo", Sheq, Fier

Për Dijeni:

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
Adresa: Rr. "Abdi Toptani", Nr.1, 1001, Tiranë

AGJENCIA KOMBËTARE E BURIMEVE NATYRORE (AKBN)
Adresa: Bulevardi "Bajram Curri", Blloku "Vasil Shanto"

INSPEKTORIATI SHTETËROR I PUNËS DHE SHËRBIMEVE SHOQËRORE
Rruga "Sheh Ahmet Pazari" Nr 10, pranë stadiumit Air Albania.

MINISTRIA E EKONOMISË DHE INOVACIONIT
Adresa: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Nr.3, Tiranë

AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE
Adresa: " Bulevardi "Bajram Curri", 1004", Tiranë

DREJTORISË VENDORE TË POLICISË FIER

Nga:

SINDIKATA E SEKTORIT HIDROKARBUR, SSH
Adresa: lagjja "29 Marsi", Km 7, Rruga Fier-Patos, Patos.
Ë: +355 685800111; Cel: 0693928395; E-mail: ssh.alb2022@gmail.com

Baza ligjore: Nenet 197, 197/1, 197/2, 197/3, 197/4, 197/5, 197/6 e vijues të ligjit nr. 7961 dt.12.07.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, dhe Neni 51 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë



Në përputhje me nenet 197, 197/1, 197/2, 197/3, 197/4, 197/5, 197/6 e vijues të ligjit nr. 7961 dt.12.07.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, dhe nenin 51 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ju njoftojmë se Sindikata e Sektorit Hidrokarbur, si përfaqësuese e punonjësve tuaj, ka vendosur të ndërmarrë veprimin sindikal të grevës për shkak të mosarritjes së marrëveshjes për pagat (Pika 9, neni 23 i Kontratës Kolektive të Punës), pavarësisht zhvillimit të procesit të ndërmjetësimit dhe pajtimit.

Për këtë arsye, në bazë të ligjeve të sipër cituara, ju njoftojmë se:

Greva do të zhvillohet më datë: 15.10.2025

- Ora e fillimit: 07:00
- Ora e mbarimit: 10:00

Më datë: 16.10.2025

- Ora e fillimit: 07:00
- Ora e mbarimit: Pa afat (deri në realizimin e marrëveshjes për pagat, Pika 9, neni 23 i Kontratës Kolektive të Punës).

Vendi ku do të zhvillohet Greva: në ambinetet e punës dhe përpara zyrave të shoqërisë në Marinëz

Gjithashtu është marrë vendim nga Këshilli Sindikal që Kryesia dhe anëtarët e Këshillit Sindikal do të hyjnë në GREVË URIE më datë 15.10.2025, ora 10:00 deri në realizimin e marrëveshjes për pagat (Pika 9, neni 23 i Kontratës Kolektive të Punës).

Greva do të zhvillohet në mënyrë paqësore, në përputhje me të gjitha normat ligjore, pa penguar punonjësit që zgjedhin të mos marrin pjesë dhe pa dëmtuar pronën apo procesin teknik. Qëllimi i saj është arritja e marrëveshjes për pagat (Pika 9, neni 23 i Kontratës Kolektive të Punës).

Sindikata e Sektorit Hidrokarbur mbetet e hapur për dialog dhe zgjidhje të drejtë të Konfliktit Kolektiv deri në momentin e fundit.

Faleminderit për mirëkuptimin!

KRYETAR

Dritan SHAHU


Sindikata e Sektorit Hidrokarbur - Shërbimi i Klientit - Rruga Fier, Patos Km. 7 Patos
T +355685800111; +35569398399 e-mail: s.alb2022@gmail.com